

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaMur® InjectoCream-100

SHTRESË E INJEKTUESHME KUNDËR LAGËSHTISË (DAMP PROOF COURSE DPC) ME BAZË SILANI PËR TRAJTIMIN E LAGËSHTISË NË NGJITJE.

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaMur® InjectoCream-100 është një koncept i ri për kontrollin e lagështisë në ngjitje. SikaMur® InjectoCream-100 është krem kundër depërtimit të ujit, në ambalazh sallami 600ml ose tubete 300ml. Aplikohet në një seri vrimash të hapura në shtresën e laçit tek muri me një pistoletë të thjeshtë aplikimi - nuk nevojitet pompë specifike injektimi. Sapo injektohet në shtresën e laçit, SikaMur® InjectoCream-100 shpërndahet brenda murit të lagësht për të formuar një pengesë kundër ujit (Dampproof course, DPC - shtresë kundër lagështisë) dhe bllokon ngjitjen e lagështisë në të ardhmen. SikaMur® InjectoCream-100 përputhet me kërkesat e Udhëzimit WTA 4-4-04/D "Injektim brenda mureve për parandalimin e lagështisë kapilare të përmbajtur".

PËRDORIMET

SikaMur® InjectoCream-100 mund të përdoret për të trajtuar lagështinë në ngjitje pothuajse në të gjitha llojet e mureve:

- Mur me tullë solide
- Mur zgavër
- Mur prej gurësh me formë të papërcaktuar dhe i mbushur me haliç, etj.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Instalim i lehtë (rrezik i ulët për gabim operativ, nuk kërkohen aftësi të veçanta).
- Me 1 përbërës, gati për përdorim.
- Instalim i shpejtë (pa 'shpim të dyfishtë', pa pritje për depërtimin e lëngut nën presion ose gravitet).

- Pa nevojë të izolimit paraprak përreth vrimave të injektimit (si tek sistemet e presionit).
- Injektim i shpejtë (nuk kërkohet kohë pritjeje për të pompuar brenda materialin në krahasim me sistemet e injektimit me presion dhe pa rimbushje si sistemet e injektimit të furnizuara nga graviteti).
- Shkallë konsistente aplikimi (lehtësi në përlogaritjen e sasisë së materialit që kërkohet).
- Nuk kërkon pompë të posaçme të shtrenjtë.
- Nuk shkaktohen papastërti nga aplikimi (pa probleme me rrjedhjet e lëngjeve nga hapësirat e mureve, kavitetet ose tubat e shërbimit).
- Formulë e koncentruar me rreth 80% përbërës aktiv (fut një sasi më të ulët materialin inaktiv brenda murit - rezultate shumë më efikase krahasuar me materiale më pak të koncentruara).
- Rrezik i ulët, me bazë ujore -jo kaustik, jo i djegshëm-nuk injektohet nën presion.
- Shumë pak firo
- Prodhon pak mbetje
- Pa rrezik të efloreshencës së shtuar (si me trajtimet kundër lagështisë në rritje me silikonate).

MIRATIME / STANDARDE

- Testuar si produkt për trajtimin e lagështisë në ngjitje të mureve nga Instituti Belg i Kërkime për Ndërtimin (Ref. raporti BE 407-695-057 data 6 korrik 2009)
- Testuar sipas Udhëzimit WTA 4-4-04/D- Raport Nr. M 1954/1 data 24 qershor 2014

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike

emulsion me bazë silani

Ambalazhi	sallam 600 ml (10 copë/ kuti) tubetë 300 ml (12 copë/ kuti)
Ngjyra	e bardhë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit nëse magazinohet saktë në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në vend të thatë në temperatura nga +5°C deri në +35°C. Të mbrohet rrezatimi i drejtëpërdrejtë diellor të dhe lagështia.
Dendësia	~0,90 kg/l (20 °C)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Numri sallameve (tubetave) të kërkuar:				
	Gjatësi muri	Trashësi muri			
		110 mm	220 mm	330 mm	440 mm
	10 m	1,5 (3)	3,0 (6)	5,1 (10,2)	7,0 (14)
	20 m	3,0 (6)	6,0 (12)	10,2 (20,4)	13,0 (26)
	30 m	4,6 (9,2)	9,0 (18)	15,3 (30,6)	21,0 (42)
	40 m	6,1 (12,2)	12,0 (24)	20,4 (40,4)	28,0 (46)
	Shënim: Kushte të ndryshme të terrenit mund të shkaktojnë ndryshime në konsumim. Gjithmonë lejoni një 10% shtesë kur llogarisni sasinë e materialit të kërkuar.				
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +35 °C max.				
	Punimet e injektimit duhet të kryhen kur temperatura nuk bie nën 0°C për të paktën 48 orë pas aplikimit për të lejuar shpërndarjen e materialit në mënyrën më optimale.				

UDHËZIME APLIKIMI

SHËNIME PËR INSTALIMIN

Shpimi i vrimës:

Që trajtimi të jetë efikas, duhet të përdoret sasia e saktë e SikaMur® InjectoCream-100. Sistemi kërkon të shpohen në qendra horizontale vrima me diametër 12 mm me distancë jo më shumë se 120 mm nga njëra tjetra. Thellësia e kërkuar vrimave për mure të ndryshme tregohet në tabelën e mëposhtme. Për të gjitha trashësitë e tjera të mureve, thellësia e vrimave duhet të jetë brenda 40 mm të anës së kundërt. Shponi horizontalisht, direkt në shtresën e llaçit, preferohet në fundin e bazës së tullës të shtresës së përzgjedhur.

Pas shpimit, çdo vrimë duhet të pastrohet tërësisht duke përdorur një fryrës ajri të kompresuar të pastër dhe të thatë.

Thellësia e vrimës me diametër 12 mm që kërkohet për SikaMur® InjectoCream-100 në trashësi të ndryshme të murit:

Trashësi muri	Thellësi vrimë	Qendrat e vrimës
110 mm	100 mm	120 mm
220 mm	190 mm	120 mm
330 mm	310 mm	120 mm
440 mm	420 mm	120 mm

Mure me tulla solide:

Muret me tullë solide mund të trajtohen nga një anë e vetme në një veprim. Kjo varet nga gjatësia e majës së

trapanit. Shponi shtresën e përzgjedhur të llaçit tek qendrat e përshkruara në thellësinë e kërkuar në përputhje me tabelën e sipërme.

Mure zgavër:

Muret zgavër mund të trajtohen nga njëra anë me një veprim të vetëm ose mund të trajtohen në secilën anë më vete. Kur ndërmerret trajtimi nga njëra anë, shponi komplet përmes shtresës së përzgjedhur të llaçit, lejoni që maja e trapanit të kalojë përmes kavitetit dhe pastaj shponi në murin tjetër me vrimën të arrijë deri 40mm nga ana e kundërt e murit (ana e pasme e murit). Viskoziteti i SikaMur® InjectoCream-100 është i tillë që mundëson trajtimin e çdo anë muri me një veprim të vetëm shpimi. Sigurohuni gjithmonë se kaviteti është i pastër përpara trajtimit. Nëse çdo anë e murit është trajtuar veçmas, trajtoni secilën anë si një mur individual tulle.

Mure prej gurësh në formë të pacaktuar dhe të mbushur me haliç:

Ndiqni shtresën e llaçit në nivelin e duhur të përzgjedhur. Nëse një gur është i llojit poroz, p.sh. gur ranor, atëherë shpimi mund të bëhet direkt në gurin poroz. Trashësitë e ndryshueshme të mureve prej guri dhe mundësia e lëvizjes së haliçeve të murit që bllokohen vrimat e injektimit shkaktojnë vështirësi për çdo sistem injektimi. Nëse ndodhin këto probleme, shponi 50% të trashësisë së murit nga të dyja anët në lartësinë përkatëse, ose shponi vrima të tjera pranë vrimave të bllokuara për të siguruar se një sasi e mjaftueshme SikaMur® InjectoCream-100 mund të injektohet për të formuar një shtresë të vazhdueshme

kundër lagështisë.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Kudo që kërkohet hiqni blinduesit dhe/ose suvanë për të identifikuar dhe ekspozuar murin original dhe shtresën e duhur të llaçit që duhet trajtuar. Matni trashësinë e secilit mur që do të trajtohet. Përcaktoni thellësinë e matësit të trapanit ose vendosni një shirit tek maja e trapanit që të identifikohet thellësia e saktë e shpimit.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Përdorimi i pistoletës së aplikimit:

- Shtypni kapësen e levës së lëshimit dhe tërhiqni pistonin e presionit deri në pozicionin maksimal
- Zhvendosni dhe hiqni tubin e furnizimit të pistoletës SikaMur® InjectoCream-100
- Vendosni sallamin ose tubetën SikaMur® InjectoCream-100 brenda pistoletës
- Pritni ose shponi fundin e dukshëm të sallamit ose tubetës
- Vendosni sërish tubin e furnizimit tek pistoletë

Injektimi:

Futni tubin e furnizimit tek pistoletë e aplikimit të SikaMur® InjectoCream-100 tek e gjithë thellësia e vrimës së shpuar. Shtypni këmbëzën e pistoletës dhe mbushni çdo vrimë plotësisht me SikaMur® InjectoCream-100 brenda 1 cm të sipërfaqes. Kur trajtoni muret zgavër nga njëra anë, mbushini plotësisht vrimat në çdo anë të murit. Hidhni sallamet e përdorura në një qese plastike dhe asgjësojeni në përputhje me rregulloret vendore.

Riparimi i vrimave:

Të gjitha vrimat e shpuara duhet ose të mbyllen ose të mbushen duke përdorur llaçe të përshtatshëm Sika.

Risuvatimi:

Ashtu si në të gjitha sistemet riparuese me shtresë kundër lagështisë, heqja e mjaftueshme dhe risuvatimi i saktë i suvasë me ndotje të brendshme nga kripërat, është një kërkesë thelbësore. Përdorni llaçin e thatë SikaMur® për këtë punim risuvatimi. Referohuni tek skeda teknike dhe Method Statement përkatëse.

KUFIZIME

- Në të gjitha rastet, shtresa e re kundër lagështisë duhet të instalohet sipas kodit përkatës të praktikës, p.sh. Kodi Standard Britanik i Praktikës për "Instalimin e shtresave kimike kundër lagështisë" BS 6576 (2005)
- SikaMur® InjectoCream-100 nuk është krijuar për aplikime impregnimi sipërfaqësor dhe nuk duhet përdorur për këtë qëllim.
- Mund të shfaqen disa njolla të bardha tek sipërfaqja përreth zonës së injektimit. Nëse kjo ndodh, thjesht fshijini me furçë kur të jenë të thata.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
SikaMur® InjectoCream-100
Mars 2019, Botimi 01.01
020707040000000002

SikaMurInjectoCream-100-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf